
BULETIN INFORMATIV

Maj 2025

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së
Shkencave të Shqipërisë**

Maj, 2025

Përmbajtje

Projekti madhor “Historia e shqiptarëve”	5
Takimi i redaksisë qendrore për projektin madhor “Historia e shqiptarëve”	6
Aktivitete	7
Nis në Vjenë punimet treditore konferenca ndërkombëtare me temën “Roli i elitave në mijëvjeçarin e parë p.e.s. midis Europës Qendrore dhe Ballkanit Jugor – me rastin studimor të “Kalorësit të Babunjës”, nga data 13 deri më 15 maj 2025	8
“Kalorësi i Babunjës”, nga sot deri më 31 korrik 2025, do të jetë i ekspozuar në Muzeun e Historisë Natyrore të Vjenës	10
Laboratori i Makinës së Mendimit, nisma e re e Mira Muratit.....	13
U zhvillua workshop-i “Inovacion në mësimdhënien e matematikës”	14
Nis punimet treditore Kongresi i Parë Ndërkombëtar i Shkencave të Shëndetit në Tiranë.....	16
U zhvillua veprimtaria me temën “Shqiptarët në koalicionin e madh antifashist të Luftës së Dytë Botërore”	21
Akademik Marenglen Verli mori pjesë në veprimtarinë e Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it të Kosovës, me rastin e 80-vjetorit të fitores mbi fashizmin.....	25
U mbajt ligjërata me temën “Zog i qiejve - Lasgush Poradeci ndërmjet pikturës dhe poezisë”	27
U mbajt simpoziumi “Lëvizja e 1968-s për revolucionarizimin e jetës në Shqipëri” ...	29
Konferenca ndërkombëtare “Menaxhimi i integruar i burimeve ujore për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit” – një platformë bashkëpunimi shkencor mbarëkombëtar.	33
“Albanoi” e Vasil S. Toles, magjia e një simfonie thellësisht shqiptare	38
Botime të reja	42
Sapo ka dalë në dritën e botimit libri më i ri i akademik Rexhep Meidanit me titullin “Mekanika kuantike - një paradigmë shekullore: shkencore, filozofike dhe teknologjike”	43

U prezantua monografia "Kinemaja para gjyqit: nga kinokronikat e gjyqeve të popullit, te filmat e vigjilencës revolucionare të masave"	44
U prezantua libri “Etnoletra shqipe” i autorit Vehbi Miftari.....	46
Të reja nga bota akademike	49
Angjelin Preljocaj u pranua si anëtar i Akademisë së Arteve të Bukura të Francës.....	50
In memoriam.....	51
Akademik emeritus Bardhyl Golemi, (1932-2025) personalitet i shquar i shkencës, anëtar i asamblesë së ASHSH u nda sot nga jeta.....	52
U mbajt ceremonia solemne për t’i dhënë lamtumirën e fundit akademik emeritus Bardhyl Golemit	54
Fjala e lamtumirës e Kryetarit të Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi për akademik emeritus Bardhyl Golemin	58

Projekti madhor “Historia e shqiptarëve”

Takimi i redaksisë qendrore për projektin madhor “Historia e shqiptarëve”

Sot, në datën 8 maj 2025, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u mbledh redaksia qendrore, Tiranë, e projektit madhor “Historia e shqiptarëve” e përbërë nga akad. Pëllumb Xhufi, prof. dr. Paskal Milo, prof. dr. Ferit Duka, prof. dr. Neritan Ceka dhe koordinаторët.



Takimi u zhvillua për të mbyllur ciklin e diskutimeve në redaksitë qendrore rreth punimeve që janë përgatitur për vëllimin e dytë të “Historisë së shqiptarëve”.

Në diskutim, Kryetari i komisionit të historisë, prof. dr. Paskal Milo dhe kryetari i Komisionit të arkeologjisë prof. Neritan Ceka vlerësuan punën e mirë të akad. Pëllumb Xhufit në përmbajtjen e kapitujve që kanë të bëjnë me periudhën e Skënderbeut në tekstin e “Historisë së shqiptarëve”: për mënyrën e re të parashtrimit të historisë, jo vetëm si histori politike, por edhe si histori e qytetërimit arbëror të kësaj periudhe.

U vlerësua gjithashtu puna e autorëve për korrigjimin e aspekteve që kanë të bëjnë me çështjet teknike, dhe u vu theksi që më tej të sqarohen termat që përcaktojnë identitetin dhe historinë e vërtetë, mbështetur në burimet njerëzore dhe ekonomike.

Në fund u ra dakord që termat të koordinohen me të gjithë autorët e vëllimit të dytë të “Historisë së shqiptarëve”.

www.akad.gov.al

Aktivitete

Nis në Vjenë punimet treditore konferenca ndërkombëtare me temën “Roli i elitave në mijëvjeçarin e parë p.e.s. midis Europës Qendrore dhe Ballkanit Jugor – me rastin studimor të “Kalorësit të Babunjës”, nga data 13 deri më 15 maj 2025

Në konferencën shkencore me temën “Roli i elitave në mijëvjeçarin e parë p.e.s. midis Europës Qendrore dhe Ballkanit Jugor – me rastin studimor të “Kalorësit të Babunjës” marrin pjesë mbi 120 studiues nga e gjithë bota.

Konferenca përqendrohet në diskutimet akademike për kulturën materiale shoqërore, mallrat, rrugët tregtare dhe rrjetet e komunikimit midis Europës Qendrore dhe Ballkanit gjatë mijëvjeçarit të parë p.e.s.




Në një kontekst më të gjerë do të diskutohen konceptet teorike për strukturat shoqërore dhe identitetet në atë periudhë. Veçanërisht, varret e zbuluara ofrojnë një pasqyrë mbresëlënëse mbi rolin e diferencuar të elitave dhe funksionet e tyre të shumanshme shoqërore, politike dhe fetaro-rituale, si dhe mbi rolet e anëtarëve elitarë, femra dhe meshkuj, bazuar në objektet e varrit.



Nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë në këtë aktivitet shkencor do të mbajnë kumtesat e tyre: akad. Adem Bunguri; prof. Neritan Ceka; prof. Bashkim Lahi; prof. asoc. Eduard Shehi.

<https://www.nhm.at/.../pressemitteilungen.../reitervonbabunja>
www.akad.gov.al

“Kalorësi i Babunjës”, nga sot deri më 31 korrik 2025, do të jetë i ekspozuar në Muzeun e Historisë Natyrore të Vjenës



Për herë të parë para komunitetit shkencor austriak dhe studiuesve ndërkombëtarë në “Kabinetin e Artë” të Muzeut të Historisë Natyrore në Vjenë – një nga muzetë më të rëndësishëm në botë, pranë Venusit të famshëm të Willendorf-it, do të rrijë i ekspozuar “Kalorësi i Babunjës”, një nga zbulimet më të jashtëzakonshme arkeologjike në Shqipëri gjatë dhjetë viteve të fundit.

Prezantimi i kësaj vepre unike 2600-vjeçare të arkeologjisë u ideaa dhe u organizua nga Ambasada e Shqipërisë në Vjenë në bashkëpunim me Institutin e Arkeologjisë, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Muzeu i Historisë Natyrore në Vjenë.

Në fjalën e saj përshëndetëse, drejtoresha e Muzeut të Historisë Natyrore të Vjenës, prof. Katrin Vohland, tha se ekspozita e veçantë “Kalorësi i Babunjës”, e paraqitur në Muzeun e Historisë Natyrore në Vjenë, përbën një tjetër moment të rëndësishëm në bashkëpunimin mbi 100-vjeçar midis Shqipërisë dhe Austrisë në fushën e kulturës dhe të kërkimit shkencor. Që nga punimet e hershme në fushën e arkeologjisë në Shqipëri nga Camilo Praschniker-i dhe Arnold Schober-i, të publikuara në vitin 1919 dhe që vazhdojnë të jenë themelore edhe sot, janë realizuar një sërë projektesh të

përbashkëta arkeologjike dhe kulturore-historike, si ekspozita dhe gjermime. Paraqitja aktuale e veçantë në Kabinetin e Artë të Muzeut të Historisë Natyrore të Vjenës përputhet në mënyrë të natyrshme me këto bashkëpunime afatgjata.



Në fjalën e tij, z. Fate Velaj, Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Austri, tha: “Çdo zbulim arkeologjik përfaqëson një ngjarje të rëndësishme në jetën shkencore dhe shoqërore, duke pasuruar njëkohësisht trashëgiminë kulturore dhe historinë e një vendi.

Megjithatë, ‘Kalorësi i Babunjës’, i zbuluar në vitin 2018 në qytetin e lashtë ilir Arnisa në fshatin Babunjë pranë Apolonisë së lashtë, si pjesë e kërkimeve shqiptaro-germane, është, sipas mendimit tim, jo vetëm një thesar për Shqipërinë, por edhe një pasuri e madhe për kërkimin arkeologjik në përgjithësi – si në Europë, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar.”

Fjalë përshëndetëse mbajti dhe drejtori i Institutit të Arkeologjisë, akad. Adem Bunguri, dhe dr. Karina Grömer, shefja e departamentit të prehistorisë të Muzeut të Historisë Natyrore të Vjenës.

“Kalorësi i Babunjës” është një statujë e jashtëzakonshme prej bronzi që paraqet një kalorës të armatosur mbi kalë.

Kjo vepër arti u zbulua në një vendbanim antik pranë Babunjës, afër qytetit antik të Apolonisë në Iliri, në Shqipërinë e sotme, gjatë gjermimeve kërkimore shqiptaro-germane në vitin 2018.



Ky objekt do të qëndrojë i ekspozuar në “Sallën e Artë” të Muzeut të Historisë Natyrore në Vjenë nga data 13 maj deri më 31 korrik 2025.

www.akad.gov.al

Laboratori i Makinës së Mendimit, nisma e re e Mira Muratit



Mira Murati, anëtare e jashtme e Akademisë së Shkencave, shefe e teknologjisë (CTO) i OpenAI-së, e vlerësuar ndërkombëtarisht si një eksperte shumë e respektuar në fushën e inteligjencës artificiale, nis një startup (sipërmarrje të re), Thinking Machines Lab (Laboratorin e Makinës së Mendimit).

Startup-i synon të ndërtojë sisteme të AI-së që janë më të kuptueshme, të personalizuar dhe më të afta se ato ekzistuese.

Mira Murati ka shprehur entuziazmin e saj për Thinking Machines Lab, që do të përqendrohet në avancimin e kërkimit dhe zhvillimit të AI-së.

Sipërmarrja e re është pritur me entuziazëm brenda komunitetit të teknologjisë dhe shumë ekspertë presin me padurim më shumë informacion rreth planeve dhe nismave të saj.

Mediet shkruajnë se në rrugëtimin e startup-it liderhipi dhe ekspertiza e Muratit do të jenë pa dyshim një forcë shtytëse pas suksesit të tij. Me Thinking Machines Lab, Murati synon të shtyjë kufijtë e kërkimit dhe inovacionit të AI-së dhe kontributet e saj mund të ndikojnë thellësisht në të ardhmen e teknologjisë.

Lexo linkun;

<https://www.facebook.com/share/1APR2ooEbH/?mibextid=wwXlfr>
www.akad.gov.al

U zhvillua workshop-i “Inovacion në mësimdhënien e matematikës”

Veprimtaria u mbajt më 24 maj 2025 nga Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike dhe Instituti Kombëtar i Matematikës, pjesë e Akademisë së Shkencave, në bashkëpunim me Departamentin e Matematikës, FSHN, Universiteti i Tiranës.

Në këtë workshop morën pjesë fizikisht dhe online matematikanë nga universitete dhe institucione shkencore shqiptare, profesorë, mësues, studentë.

Veprimtarinë e hapi prof. dr. Fatmir Hoxha, anëtar i bordit të Instituti Kombëtar të Matematikës (IKM), i cili kërkoi të mbahej 1 minutë heshtje për humbjen e jetës të prof. dr. Kostaq Hila, dekan i FIMIF, Universiteti Politeknik i Tiranës dhe anëtar i IKM-së.



Akad. Neki Frashëri, Kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike përshëndeti në emër të Kryesisë së Akademisë.

Prof. dr. Eglantina Kalluçi, dekane e FSHN-së, UT përshëndeti në emër të dy departamenteve të matematikës si bashkëorganizatorë.

Kjo veprimtari shërbeu për të eksploruar metoda mësimdhënieje që përdorin, ku ekspertë të fushës dhe pjesëmarrësit patën mundësinë të ndajnë përvoja dhe të mësojnë praktika të reja që mund të implementohen në klasat e tyre. Një nga objektivat kryesore është që mësuesit të pajisen me mjetet më të fundit të teknologjisë për të përmirësuar

mësimdhënien dhe më tej krijimi i një rrjeti bashkëpunimi mes mësuesve dhe studiuesve për të ndarë praktikat më të mira për të motivuar nxënësit nëpërmjet teknologjisë.



Workshopi u organizua nga prof. asoc. Eriola Sila, anëtare e KMI-së, dhe dr. Florion Çela, koordinator i IKM-së.

Gjatë tri sesioneve të zhvilluara, prof. dr. Valentina Sinaj, prof. asoc. Frederik Dara, prof. asoc. Robert Kosova, prof. asoc. Besiana Hamzallari, prof. asoc. Eriola Sila, prof. asoc. Lekë Pepkolaj (online), dr. Brunilda Lufi, dr. Ledia Subashi, si dhe mësuesit msc. Oriana Mema, Mirjana Canellari, Leonard Hajdari, trajtuan çështje të rëndësishme si: metodat inovative të mësimdhënies në matematikë; softet edukativë; roli i internetit në edukim; përdorimi i programeve kompjuterike dhe integrimi i inteligjencës artificiale në mësimdhënien e matematikës; mësimi përmes simulimeve dhe vizualizimeve interaktive, roli i platformave online dhe mësimi në distancë; përdorimi i analizës së të dhënave për të personalizuar mësimdhënien e matematikës, si dhe praktikat më të mira për të motivuar nxënësit nëpërmjet teknologjisë.

Në fund u diskutua rreth temave të prezantuara dhe u bënë sugjerime për trajtimin e qasjeve të reja pedagogjike ndaj inteligjencave të shumëfishta dhe për përmirësimin e mëtejshëm të metodologjive dhe mësimdhënies në matematikë.

www.akad.gov.al

Nis punimet treditore Kongresi i Parë Ndërkombëtar i Shkencave të Shëndetit në Tiranë

- Akad. Skënder Gjinushi, Kryetari i Akademisë së Shkencave mbajti një fjalë përshëndetëse



Kongresi i parë Ndërkombëtar i Shkencave të Shëndetit nisi ditën e parë të punimeve sot, më 2 maj 2025, në Tirana International Hotel.

Gjatë tre ditëve të zhvillimit të këtij kongresi mbi 600 ekspertë të njohur kombëtarë dhe ndërkombëtarë dhe profesionistë të fushës së shëndetit do të paraqesin punimet shkencore për zhvillimet më të fundit në fushën e shkencave mjekësore, si dhe mundësitë për avancimin e kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Kongresi u organizua nga Universiteti i Mjekësisë me mbështetjen e institucioneve akademike dhe profesionale nga Shqipëria dhe vende të tjera.

Në hapje të ceremonisë mbajtën fjalë përshëndetëse prof. Xheladin Draçini, rektori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; prof. Carmelo Rizzo, ekspert në fushën e nutricionit dhe në fushën e sëmundjeve alergjike; akad. Skënder Gjinushi, kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; znj. Albana Koçiu, ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe znj. Ogerta Manastirliu, ministrja e Arsimit dhe Sportit.

Më poshtë:

Fjala përshëndetëse e plotë nga Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë:

I nderuar z. Rektor,

Të nderuara zonja ministre e Shëndetësisë, znj. Koçiu dhe e Arsimit znj. Manastirliu,

Të nderuar kolegë dhe miq,

Të nderuar organizatorë dhe pjesëmarrës,

Të nderuar përfaqësues të institucioneve akademike, kërkimore dhe shëndetësore nga vendi dhe jashtë,

Kam kënaqësinë dhe nderin e veçantë që, në emër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, të përshëndes hapjen e këtij Kongresi të Parë Ndërkombëtar të Mjekësisë, një ngjarje madhore për komunitetin shkencor dhe mjekësor shqiptar.

Lidhja midis Akademisë së Shkencave dhe Fakultetit të Mjekësisë është një lidhje historike dhe e thellë. Që nga themelimi i Akademisë, disa prej figurave më të ndritura të mjekësisë shqiptare kanë qenë anëtarë të saj, duke kontribuar në ndërtimin e themeleve të një shkence mjekësore kombëtare. Ky bashkëpunim ka shërbyer ndër vite si urë ndërlidhëse ndërmjet kërkimit shkencor dhe praktikës mjekësore.



Është për t'u përshëndetur iniciativa e organizimit të këtij kongresi të parë ndërkombëtar të shkencave të shëndetit me pjesëmarrjen e specialistëve nga tërë institucionet e vendit, Shqipëri e Kosovë e të partnerëve të tyre të huaj, pasi veprimtari

të tilla shërbejnë realisht si tribuna të debatit shkencor e të shkëmbimit të përvojave midis homologeve mbi prirjet e të rejat e shkencës.

Me ritmet që ka zhvillimi shkencor, e veçanërisht ai teknologjik, është jetike për çdo specialist të lartë, aq më shumë për çdo mjek, që të ndjekë ritmet e këtij zhvillimi për të mundësuar që, nga terapitë, protokollet e teknikat e reja të përfitojnë edhe pacientët këtu në Shqipëri.



Iu takon komunitetit të specialistëve e institucioneve të interesuara si universiteti juaj e Akademisë së Shkencave, që të nxisin edhe administratën shtetërore e politikëbërësit për t'i dhënë rëndësinë e duhur futjes së të rejave shkencore e njohjes me to, jo vetëm në ciklet kryesore të arsimit universitar e postuniversitar, por edhe në radhët e ushtruesve të specialitetit përkatës, për t'u kuptuar e zbatuar gjithnjë e më mirë fakti se sistemi shëndetësor nuk përmirësohet vetëm me masa administrative, investime infrastrukturore e logjistike etj., pa u shoqëruar me zhvillimin e zgjerimin e kërkimit e të studimeve shkencore. Në rast se në disiplinat e tjera kjo është e nevojshme, në mjekësinë e sotme është e domosdoshme.

Është kjo arsyeja që ne si Akademi e Shkencave e shohim të domosdoshëm bashkëpunimin me shkollat e larta e Universitetin e Mjekësisë, si dhe me tërë komunitetin arsimor e shkencor në vend, për të reformuar sistemin tonë të kërkimit shkencor, me synim afrimin me nivelin e standardet europiane.

Në mënyrë deklarative është e gjithëpranuar se investimet në shkencë e arsim janë më fitimprurëset në afatgjatë. Mirëpo këtë, deri dje e thoshin të gjithë, e kuptonin disa madje dhe e zbatonin pak. Zhvillimet më të fundit të inteligjencës artificiale, kontributi i shkencave të shëndetit në përballimin e pandemisë COVID-19, pavarësisht nga teoritë konspirative e antishkencë që vazhdojnë të propagandohen edhe sot, edhe në mediet tona, kanë bërë që tashmë të gjithë të kuptojnë konkretisht se investimi në

shkencë e arsim ka efekte të menjëhershme; të kuptojnë se sot nuk mund të përballohet asnjë konkurrencë në çdo fushë pa teknologjitë e reja.

Bashkimi European deklaron hapur se sfida kryesore e këtij bashkimi në rang botëror është konkurrenca me kontinentet e rajonet e tjera në fushën e shkencës, në shkallën e shtrirjes së inteligjencës artificiale.

Pra, ne ndodhemi në një moment kur shkenca është vënë në plan të parë në Europë, e ndërkohë, investimi për të ne është më i ulëti në raport me sektorët e tjerë.

Përvoja jonë e deritanishme na tregon se inteligjenca shqiptare me gjithë problemet e traumat e mirënjohura i ka mbijetuar tranzicionit, se Shqipëria i ka kapacitetet intelektuale për ndjekjen e ritmeve të zhvillimit të shkencave në tërësi, këtë e dëshmon edhe niveli profesional i trupës mjekësore në tërësi e niveli i formimit të mjekëve të rinj në Universitetin e Mjekësisë, por ky potencial duhet mbështetur, duke i krijuar kushtet për përfshirjen sa më të gjerë në kërkimin shkencor.

Kjo është dhe masa më efektive për ndalimin e ikjes së trurit, apo për minimizimin e efekteve të tij, duke afruar kolegët tanë që punojnë jashtë të kontribuojnë në distancë, siç dëshmon dhe pjesëmarrja e disa prej tyre në këtë kongres.



Këtij qëllimi i shërben edhe reforma e ndërmarrë katër vitet e fundit nga Akademia e Shkencave, duke synuar ngritjen e qendrave të reja të kërkimit e fuqizimin e atyre ekzistuese.

Në këtë kuadër, një nga zhvillimet më të rëndësishme në fushën e shëndetit ka qenë krijimi i Komisionit të mjekësisë pranë Akademisë dhe më pas ngritja e Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës, e cila është vendosur pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” e me një vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave, në maj 2024, mori statusin e një Qendre të Përhershme Kërkimore.

Hapat e parë të kësaj Qendre kanë qenë të lidhur ngushtësisht me studimin e përgjigjes imunitare të popullatës shqiptare ndaj COVID-19.

Sot, kjo Qendër është e angazhuar në një sërë projektesh kërkimore me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare, ndër të cilat dallohen ato që trajtojnë studimin gjenetik të popullatës shqiptare dhe identifikimin e markuesve gjenetikë të lidhur me sëmundje të ndryshme.

Këto projekte nuk mbeten vetëm në sferën e kërkimit shkencor teorik. Një shembull i qartë është projekti për sëmundjet autoimune të sistemit nervor, në kuadrin e të cilit janë aplikuar shtatë ekzaminime të reja laboratorike.

Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës përfaqëson sot një model të suksesshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional e të integritit të kërkimit me praktikën klinike dhe formimin profesional.

Ky integrim është institucionalizuar përmes marrëveshjeve të posaçme trepalëshe, ndërmjet Akademisë së Shkencave, Universitetit të Mjekësisë dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, duke vendosur themelet për një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe me perspektivë.

Në të ardhmen synimi ynë është që ky bashkëpunim të zgjerohet më tej, sidomos në formimin dhe përgatitjen shkencore të brezit të ri të studiuesve dhe profesionistëve të fushës së bioteknologjisë dhe mjekësisë moderne, duke e bërë Shqipërinë një pikë referimi për kërkimin në rajon.

Të nderuar pjesëmarrës, duke ju uruar punime të mbara, shpresoj që ky Kongres të jetë një platformë e denjë për të paraqitur arritjet e shkencës mjekësore shqiptare dhe të vendosë gurët e parë të themelit për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të avancuar të kërkimit shkencor në fushën e shëndetit.

Ju faleminderit për vëmendjen, suksese në punimet e Kongresit, dhe ju ftojme që Kongresin e radhës ta mbajmë në Akademinë e Shkencave!

www.akad.gov.al

U zhvillua veprimtaria me temën “Shqiptarët në koalicionin e madh antifashist të Luftës së Dytë Botërore”

Sot, në datën 7 maj 2025, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua veprimtaria me temën “Shqiptarët në koalicionin e madh antifashist të Luftës së Dytë Botërore”. Kjo veprimtari u organizua nga Seksioni i Shkencave shoqërore dhe Albanologjike, pjesë e ASHSH-së dhe një grup pasardhësish të veteranëve të LANÇ-it në kuadër të 80-vjetorit të përfundimit të Luftës II Botërore.

Veprimtaria u moderua nga drejtori i Institutit të Historisë prof. dr. Hamit Kaba, dhe prof. dr. Ksenofon Krisafi.

Kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike akad. asoc. Gëzim Hoxha mbajti fjalën përshëndetëse në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.



Ai u shpreh se në këtë përvjetor të rëndësishëm Akademia e Shkencave kujton me nderim kontributin e të gjitha forcave antifashiste të popujve dhe të lëvizjeve të rezistencës që sfiduan tiraninë dhe mbrojtën idealet e demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Më tej, ai theksoi se Akademia e Shkencave e riafirmon sot se antifashizmi është dhe mbetet një vlerë universale, e cila bashkon popuj dhe kultura të ndryshme përtej kufijve kombëtarë dhe ideologjikë. Ai mishëron parimet e solidaritetit të paqes dhe të bashkëjetesës, të cilat janë themeli i shoqërive moderne dhe demokratike.

Në fund akad. Hoxha e vuri theksin tek puna e Akademisë së Shkencave për ndërmarrjen e projektit për botimin e ri të historisë së popullit shqiptar, duke e pasuruar me dokumente të reja dhe argumente të bazuara të ngjarjeve që përkujtohen në këtë veprimtari.

Fjalë përshëndetëse mbajti edhe veterani z. Naxhi Zhupa, ish-partizan i Brigadës VIII. Ai shprehu krenarinë që rreth 416 ditë me radhë ishte pjesëmarrës në një luftë që do ta bënte Shqipërinë të njohur dhe të nderuar në të gjithë botën. Z. Xhupa theksoi se lufta antifashiste në Shqipëri pati një vlerë të veçantë për krijimin e ushtrisë së parë partizane, e cila u bë edhe ndihmëse e aleatëve.

Prof. dr. Ksenofon Krisafi paraqiti një studim për kontributin e shqiptarëve në fitoren mbi fashizmin. Ai theksoi se duhet bërë një vlerësim objektiv, në një kohë që po prekej pavarësia e vendit dhe territoret e tij po kërcënoheshin. Prof. dr. Kristafi përmes argumenteve dhe shifrave konkrete e vlerësoi kontributin e luftës partizane, të lidhur me vizionin largpamës të atyre që patën në krye, që i radhiti shqiptarët në krahun e aleatëve fitues dhe i vuri në ballë të faqes së lavdishme të historisë së luftës kundër nazifashizmit.



Prof. asoc. dr. Ethem Çeku paraqiti një studim për rikthimin e Kosovës nën Jugosllavi gjatë viteve 1944 – 1945. Ai përshkoi historinë e pushtimit dhe rezistencës përmes qasjeve dokumentare dhe krahasimore. Procesin e rikthimit të Kosovës në Jugosllavi ai e paraqiti si një ndërmarrje ushtarako- politike të pranuar nga faktori ndërkombëtar dhe që u realizua në kundërshtim me aspiratat kombëtare të shqiptarëve. Ai theksoi se ndërsa shqiptarët u bashkuan në luftën kundër fashizmit, rikthimi i Kosovës në administrimin jugosllave shënoi një nga momentet më të dhimbshme dhe tragjike në historinë moderne të shqiptarëve në rajon.

Prof. dr. Pëllumb Xhufi paraqiti një studim të mbështetur në arkivat për forcat politike në Shqipëri, gjatë Luftës së Dytë Botërore, parë në përputhjet dhe mospërputhjet e tyre me qëndrimet e aleancës Anglo- Sovjeto-Amerikane.

Akad. Xhufi e vuri theksin në një nga pikat kyçe të historisë që ndryshoi rrjedhën e ngjarjeve gjatë Luftës II Botërore. Ishte pikërisht data 21 qershor e vitit 1941 e sulmit të Gjermanisë naziste mbi Bashkimin Sovjetik. Të nesërmen në 22 qershor Winston Churchill mbajti një fjalim historik nga valët e Radio - Londrës për shpartallimin e Hitlerit dhe çdo gjurmë të regjimit nazist. Akad. Xhufi përshkroi në studimin e tij sesi shumica e vendeve ndryshuan pozicionet e tyre në marrëdhëniet dhe qëndrimet diplomatike për një angazhim total dhe krijimin e aleancave të mëdha në luftën kundër nazi-fashizmit.

Prof. dr. Hamit Kaba paraqiti studimin me temën “E ardhmja e Kosovës në mbarim të Luftës së Dytë Botërore dhe aleatët e mëdhenj”. Ai theksoi se Kosova dhe territore shqiptare iu bashkuan Jugosllavisë me forcë. Problemi i Kosovës nuk u shtrua fare në Konferencën e Paqes, sikurse ishte artikuluar disa herë në Luftën II Botërore. Aleatët nuk kishim motive të mjaftueshme që të merreshin me zgjidhjen problemit të Kosovës dhe të respektonin Kartën e Atlantikut, ndërsa shteti shqiptar nuk e kishte as vullnetin dhe as prestigjin ndërkombëtar të kërkonte Kosovën, në një kohë që konfigurimi i Ballkanit ishte në favor të Moskës, e cila ishte aleate e Jugosllavisë. Edhe për Britaninë e Madhe peshorja anonte nga Jugosllavia. Në argumentet e mëtejshme ai përmendi faktin që shteti shqiptar ende nuk konsiderohej zyrtarisht si vend aleat i luftës, nuk ishte pranuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe nuk kishte vendosur marrëdhënie diplomatike me SHBA-në dhe Britaninë e Madhe.



Prof. asoc. Marenglen Kasmi në studimin e tij e përcaktoi antifashizmin si një vlerë të patjetërsueshme europiane dhe foli për sfidat e sotme. Ai theksoi se sot antifashizmi në tërësinë e tij përballlet me një sërë sfidash të reja: rritja e ekstremizmit të djathtë, përhapja e teorive konspirative dhe relativizimi i krimeve të regjimeve fashiste e naziste, të cilat përbejnë kërcënime serioze ndaj kujtesës historike dhe vlerave të antifashizmit. Prof. asoc. Kasmi theksoi se përpjekjet për të barazuar komunizmin me nazizmin në diskursin europian rrezikojnë të zbehin dallimin thelbësor midis qëndresës dhe bashkëpunimit me të keqen. Në Shqipëri sfida më e madhe është tendenca për të zhveshur përgjegjësitë historike dhe për të fshehur bashkëpunimin e një pjese të elitave politike dhe intelektuale të kohës me pushtuesit.



Veprimtaria vijoi me kumtesën e prof. asoc. Bernard Zotaj, i cili vlerësoi misionin historik të divizioneve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare dhe kontributin e ushtrisë partizane, si dhe dëshmorët e rënë përtej kufijve shtetërorë të atdheut. Ai tha se kalimi i divizioneve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare përtej kufijve shtetërorë, në ndjekje të ushtrisë gjermane me luftime e beteja të përgjakshme deri në Vishegrad, është argumenti më i pakundërshtueshëm se ajo ishte një luftë e pastër nacionalçlirimtare, siç ishte për të gjitha vendet e pushtuara nga nazifashizmi. Me këtë akt populli shqiptar do të radhitej me dinjitet përkrah fitimtarëve, për herë të parë në histori.

Prof. asoc. Teki Kurti foli për qëndrimin e Kombeve të Bashkuara dhe rezistencën antifashiste nacionalçlirimtare në Shqipëri në Luftën e Dytë Botërore.

Në fund, u bënë diskutime për temat e trajtuara në këtë veprimtari shkencore lidhur me kujtesën historike, si dhe ndikimin e ngjarjeve globale në periudhën e Luftës II Botërore në historinë e shqiptarëve.

www.akad.gov.al

Akademik Marenglen Verli mori pjesë në veprimtarinë e Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it të Kosovës, me rastin e 80-vjetorit të fitores mbi fashizmin



Akad. Marenglen Verli, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, me një ftesë të veçantë, në datën 9 maj 2025 mori pjesë në një veprimtari të Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it të Kosovës dhe degës së saj në Gjakovë. Kjo veprimtari u organizua me rastin e 80- vjetorit të fitores mbi fashizmin dhe Ditës së Europës.

Veprimtaria nisi me një ceremoni përkujtimore me vendosjen e kurorave me lule në varrin e Heroit të Popullit Fadil Hoxha e Vaide Hoxha dhe në varrezat e dëshmorëve të UÇK-së.

Z.Gazmend Hoxha, kryetari i Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it të Kosovës, dega Gjakovë, hapi ceremoninë me një fjalë përshëndetëse. Më tej, përshëndetën kryetari i Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it të Kosovës dhe Tatjana Parllaku kryetare e OBV-së në Shqipëri.

Në vijim u zhvillua një veprimtari shkencore, në të cilën u mbajtën tri ligjërata.

Akad. Jusuf Bajraktari mbajti ligjëratën me temën “Idealizmi shqiptar në ndërhyrjet dramatike të Luftës II Botërore”.

Akad. Verli paraqiti ligjëratën me temën "Faktorët që pengonin Fuqitë e Boshtit të kryenin rekrutimin masiv në Kosovë".



Prof. Gëzim Ibrahim Prengzi mbajti një ligjëratë për pasojat që pati Malësia e Gjakovës pas mohimit të vendimeve të Konferencës së Bujanit".

Në fund, rreth ligjëratave u zhvilluan diskutime me të pranishmit.

Veprimtarinë e mbylli nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it, z. Bashkim Hisari.

www.akad.gov.al

U mbajt ligjërata me temën “Zog i qiejve - Lasgush Poradeci ndërmjet pikturës dhe poezisë”

Studiuesja e artit Suzana Varvarica Kuka mbajti sot në datën 27 maj 2025 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë një ligjëratë me temën “Zog i qiejve - Lasgush Poradeci ndërmjet pikturës dhe poezisë”.

Veprimtaria u organizua nga Komisioni i Arteve, pjesë e Akademisë së Shkencave, dhe u moderua nga Anisa Ymeri.



Fillimisht studiuesja Varvarica foli për personalitetin e Lasgush Poradecit (1899-1987) dhe solli në vëmendjen e të pranishmëve vlerësimin që i ka bërë shkrimtari i madh Ismail Kadare në korrik 2019 nëpërmjet një interviste: “Gjer më sot Lasgush Poradeci ka mbetur për mua njeriu më i jashtëzakonshëm, më i ndërlikuar e më i pakuptueshëm që kam njohur...Duke e parë, dhe sidomos duke e dëgjuar, gjithmonë mendoja se si ishte e mundur që njeriu ballkanas, njeriu shqiptar, të arrinte një ndërlikim të tillë, përkryerje, mëvetësi dhe mister...”.

Ajo theksoi se Lasgush Poradeci në vitet ‘30 të shekullit XX ishte poeti më i njohur shqiptar. Vargjet e tij poetike lexoheshin ethshëm nga rinia studentore e kohës.

Më tej, Varvarica paraqiti një vështrim të shpejtë mbi kohën e jetës së Lasgush Poradecit dhe në kohët e krijimtarisë së tij në artet pamore, të cilat kanë qenë shumë të

rëndësishme për poetin artist. Këto kohë përfshijnë krijimtaritë e kryera gjatë qëndrimit të tij në Greqi, Rumani, Austri, Shqipëri në vitet '40 e në vijim.



Studiuesja e njohur spikati në ligjëratën e saj fijet që i lidhin zhanret e artit të Lasgushit me njëri-tjetrin. Ajo vuri në dukje se të gjitha subjektet e personazheve femërore që pikturoi e vizatoi, e gjejnë psikun e tyre në vargjet e derdhura në poezitë e cikleve “Ylli i zemrës” dhe “Zemra e ime”, duke mos i anashkaluar të gjitha ciklet e tjera të botuara në veprat madhore të poezive filozofike dhe baladave.

Gjatë ligjërimit u lexuan poezi të Poradecit nga e bija Marie Gusho dhe moderatorja Anisa Ymeri.

Maria Gusho foli për disa nga motivet jetësore të poezisë, të zbuluara nga arkiva e poetit, si dhe për pasurinë e këtyre arkivave. Gjatë rrëfimeve ajo e vuri theksin te pesha që i jepte fjalës poetike Lasgush Poradeci dhe te koncepti i tij për latinimin dhe përsosurinë e vargut poetik.

Ligjëratat u mbyll me diskutimet për persekutimin e heshtur dhe indiferentizmin shtetëror ndaj personalitetit të tij si doktor i shkencave filozofike dhe si një poet brilant i ndjenjave njerëzore të derdhura në vargje, ku psikologjia njerëzore është kryefjala e tyre.

www.akad.gov.al

U mbajt simpoziumi “Lëvizja e 1968-s për revolucionarizimin e jetës në Shqipëri”



Sot, në datën 29 maj 2025, u mbajt simpoziumi “Lëvizja e 1968-s për revolucionarizimin e jetës në Shqipëri”.

Veprimtaria u organizua nga Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, Komisioni i përhershëm i antropologjisë dhe i trashëgimisë kulturore, në bashkëpunim me Departamentin e shkencave politike, Universiteti i Tiranës, dhe Autoritetin e Dosjeve (AIDSSH).

Simpoziumi synon njohjen e dinamikave dhe studimeve të kryera deri më sot mbi ndikimin që ka pasur Lëvizja e 1968-s në Shqipëri; vështtrimin analitik të ndikimit të Revolucionit Kulturor Kinez (mëvetësia e rastit shqiptar), si dhe paraqitjen e disa rasteve studimore mbi këtë argument, përfshi dhe risitë e sjella nga botimi “Antikultura e ‘68-s në Shqipëri” të autorit Albert Nikolla.

Akad. Gëzim Hoxha, Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, ASHSH, hapi veprimtarinë dhe vlerësoi programin e simpoziумit për interesin dhe rëndësinë që kanë tematikat e trajtuara për ta analizuar fenomenin në kuptimin e studimit shkencor antropologjik dhe i uroi pjesëmarrësit për mbarëvajtjen punimeve të kësaj konference.

Kryetari i Komisionit të përhershëm të antropologjisë dhe trashëgimisë kulturore, akad. Albert Doja, tha se kjo është veprimtaria e parë e këtij komisioni të ri.

Me këtë rast, ai e falënderoi autorin për nismën e tij për organizimin e simpoziumit “Lëvizja e 1968-s për revolucionarizimin e jetës në Shqipëri” dhe për kontributin që sjell trajtimi i kësaj tematike në zgjerimin e fokusit të qasjeve antropologjike.



Seanca nisi me kumtesën e prof. dr. Enika Abazit me temën “Revolucioni i 1968-s në Shqipëri: Revolucionarizimi i mendimit dhe identitetit: Ideali i 'Njeriut të Ri' dhe procesi i transformimit ideologjik”. Ajo vuri në dukje se gjatë periudhës komuniste në Shqipëri, kultura u rikonceptua si një superstrukturë e kontrolluar nga shteti, duke u fokusuar në ndërtimin e një identiteti kolektiv në përputhje me doktrinën marksiste-leniniste. Me metodën e realizmit socialist u çmontuan vlerat tradicionale, duke i zëvendësuar me një diskurs të ri ideologjik. Ajo tha se trashëgimia e kësaj përvoje kërkon analiza të vazhdueshme për të kuptuar sfidat e ndërtimit të një shoqërie të lirë dhe demokratike. Pavarësisht rënies së regjimit në vitin 1991, ndikimi i këtij modeli vazhdon të ndjehet. Studimet tregojnë se individët vazhdojnë të tregojnë prirje për konformizëm, mungesë iniciative dhe pasiguri përballë ndryshimeve, si pasojë e socializimit të gjatë totalitar.

Më tej, prof. asoc. Klodiana Beshku mbajti një kumtesë të përgatitur në bashkëpunim me prof. as. Klejd Këllicin me temën “Viti 1968: Vala e dytë e feminizmit në Perëndim dhe ‘emancipimi si sakrificë’ në Shqipëri”. Kjo analizë shtrihet përgjatë viteve 1945-1979, vite kur diskursi emancipues është në pikun e tij dhe do të ndalet në

periudhën 1968-1969, nëpërmjet një vështrimi krahasues me atë çka ndodhte në Europë dhe në SHBA në të njëjtën kohë. Ajo tha se në periudhën e komunizmit politik emancipuese u përshtatën, në mos replikuan me modelin sovjetik, e përshtatën atë aq sa të mos trondiste thelbësisht themelet e shoqërisë tradicionale. Gruaja mund të çlirohej dhe të emancipohet, por vetëm brenda familjes dhe nën efektin dhe drejtimin e partisë-shtet.”



Prof. asoc. Albert P. Nikolla paraqiti një analizë për tragjedinë e imitimit të revolucionit kulturor kinez në kontekstin shqiptar, dhe posaçërisht në shkatërrimin e kishës katolike, si dhe dokumentet që nxjerrin në dritë qëndrimin e regjimeve komuniste ndaj kishës katolike. Më tej, ai paraqiti një rast studimor antropologjik në fshatin Hajmel të Shkodrës. Pikënisja e studimit zuri fill nga një botim i vitit 1967, ku grupe njerëzish nga krahina të ndryshme të vendit i shkruanin Enver Hoxhës mbi vendimet që kishin marrë për shkatërrimin e kishave dhe “demaskimin” e priftërinjve. Ai vuri në dukje se veprat e E. Hoxhës përbëjnë një burim interesant antropologjik, pasi qëllimi i tyre, më shumë sesa njohje teorike e zhvillimeve të socializmit shqiptar, ishte “të udhëzonin mënyrën e sjelljes” së “njerëzve të rinj të socializmit”, ku përgjatë hulumtimit dalin në pah udhëzimet konkrete se si duhen sulmuar kishat dhe si duhen “demaskuar” priftërinjtë. Ai theksoi se ka mjaft elementë antropologjikë që na shtojnë të mendojmë se Revolucioni Kulturor Kinez ka patur një ndikim të madh në ngjarjet e vitit 1967. Në fjalimin e 6 shkurtit të vitit 1967, që shënon edhe vendimarrjen kryesore për

orientimin e Shqipërisë si provincë kineze nën eksperimentimin e revolucionit kulturor, gjithçka që kumtohet në këtë fjalim është nën shenjën e dhunës.

Prof. asoc. Majlinda Keta mbajti një kumtesë për profilin filozofik të njeriut të ri në socializëm përballë demokracisë postkomuniste të viteve '90 në Shqipëri.

Mrs. Elona Baçi bëri një paraqitje interesante të disa dosjeve të Arkivit të Dosjeve mbi Festivalin e 11-të të Këngës në RTSH, ku veçoi rastin e dosjeve të përpunuara për këngëtarin Sherif Merdani, një ndër artistë të dënuar me burg për frymën moderne të këtij festivali. Më tej ajo foli për lëvizjen e Spaçit.



Në fund u bënë diskutime dhe konkluzionet rreth tematikës së simpoziumit, ku u theksua se viti 1968 në historiografinë botërore tashmë ka hyrë si “viti i demonstratave”. Lëvizja botërore e vitit 1968 në Francë ndikoi edhe në revolucionarizimin e jetës në Shqipëri, por nuk ishte thjesht një pasqyrim i lëvizjeve globale. Më shumë se drejtësi sociale dhe civile, emancipim të shoqërisë, ajo ishte një projekt i kontrolluar për të krijuar një shoqëri të re, ku krijimi i "Njeriut të ri" revolucionar ishte qëllimi kryesor.

www.akad.gov.al

Konferenca ndërkombëtare “Menaxhimi i integruar i burimeve ujore për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit” – një platformë bashkëpunimi shkencor mbarëkombëtar

Në datat 29–30 maj 2025, në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, u zhvillua Konferenca e dytë ndërdisiplinore në fushën e ujërave, një bashkëorganizim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH) nëpërmjet Njesisë kërkimore “Burimet ujore”, Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK) dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM).

Veprimtaria u mbajt në nderim të akad. Salih Gashit, një nga themeluesit e kësaj nisme dhe pjesëmarrës i përhershëm në këto takime, i cili u nda nga jeta pak kohë përpara zhvillimit të kësaj konference.

Në këtë konferencë morën pjesë akademikë, lektorë dhe profesionistë nga Shqipëria dhe Kosova, si dhe lektorë të ftuar nga Austria dhe Polonia, duke e bërë aktivitetin një platformë të gjerë shkëmbimi idesh dhe përvojash.

Në fjalën hapëse, dr. Roza Allabashi, theksoi rëndësinë e kësaj platforme si një urë bashkëpunimi ndërshqiptar e ndërkombëtar për çështjet e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve ujore.

Konferenca u përshëndet në emër të Kryesisë dhe të Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nga zëvendëskryetari i saj, akad. Vasil Tole, i cili nënvizoi se kjo veprimtari përbën vazhdimësinë e një bashkëpunimi të nisur me sukses në Prishtinë dhe përfaqëson një model të shkëlqyer të integritit shkencor në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm.



Në fjalën e saj përshëndetëse, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, znj. Anila Denaj, vuri theksin në rëndësinë e bashkëpunimeve akademike me rrjetin european të kërkimit. Ajo theksoi sfidat e menaxhimit të burimeve ujore në kontekstin e ndryshimeve klimatike dhe nevojën për mbështetje të vazhdueshme institucionale.



Zëvendësministri i Turizmit dhe Mjedisit, z. Sofjan Jaupaj, theksoi se zhvillimi i turizmit duhet të jetë i pandarë nga menaxhimi i integruar i burimeve ujore dhe se përmbushja e kërkesave të Kapitullit 27 të *Acquis Communautaire* – i cili trajton mjedisin dhe ndryshimet klimatike – në kontekstin e negociatave të Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Europian, kërkon investime të mëdha dhe bashkëpunim ndërsektorial e ndërkufitar.



Në fjalën e tij përshëndetëse, akad. Fetah Podvorica, theksoi rëndësinë e menaxhimit të përmirësuar të burimeve ujore si bazë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, veçanërisht në sektorë të ndjeshëm si turizmi dhe bujqësia. Ai nënvizoi nevojën për pastrimin dhe rikuperimin e burimeve të ndotura, si dhe për përfshirjen e institucioneve kërkimore në hartimin e politikave të qëndrueshme. Ndërkohë, akad. asoc. Besnik Baraj vuri në dukje rolin kyç të komunitetit shkencor në përballimin e sfidave të menaxhimit të ujërave, veçanërisht në kushtet e presioneve nga ndotja, urbanizimi dhe ndryshimet klimatike. Ai theksoi rëndësinë e përdorimit të informacionit shkencor për ndërtimin e politikave efektive dhe të qëndrueshme, si dhe rolin e edukimit për ndërgjegjësimin publik dhe forcimin e kapaciteteve vendimmarrëse.



Prof. Thomas Ertl, nga Universiteti BOKU, Austri, paraqiti risitë e Direktivës së re të BE-së për trajtimin e ujërave të zeza urbane (2025), e cila promovon një qasje të integruar dhe të qëndrueshme, në përputhje me Marrëveshjen e Gjelbër Europiane. Një theks të veçantë në prezantimin e tij iu dha menaxhimit të ujërave të përmytjeve përmes zgjidhjeve natyrore si çatitë e gjelbra dhe sipërfaqet e depërtueshme, për të përmirësuar qëndrueshmërinë klimatike në mjediset urbane.

Gjatë dy ditëve të konferencës u zhvilluan pesë sesione shkencore që trajtuan çështje kyçe për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit. Temat u prezantuan në mënyrë ndërdisiplinore, duke përfshirë qasje nga shkencat natyrore, inxhinierike, mjedisore dhe sociale.

Një grup i rëndësishëm diskutimesh iu kushtua politikave mjedisore dhe ndikimit të ndryshimeve klimatike, në kontekstin e negociatave për Kapitullin 27 të Bashkimit Europian. U trajtua nevoja për përafrimin e legjislacionit me direktivat e BE-së, përfshirë Direktivën Kuadër për Ujërat dhe atë për Trajtimin e ujërave të zeza urbane, me theks në investimet e nevojshme për infrastrukturë moderne dhe teknologji efikase. Një tjetër bllok tematik u përqendrua te gjendja ekologjike e ekosistemeve ujore dhe ndikimi i faktorëve njerëzorë, si urbanizimi dhe shfrytëzimi i lumenjve. U prezantuan vlerësime të statusit ekologjik të lumenjve dhe liqeneve në Shqipëri dhe Kosovë, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit dhe shërbimeve që këto ekosisteme ofrojnë për sektorë si turizmi dhe bujqësia. Ndotja plastike dhe ndotësit emergjentë, përfshirë mikrondotësit dhe komponimet organike të qëndrueshme, ishin gjithashtu në fokus. U paraqitën studime mbi ndotjen nga mbetjet plastike në lumenjtë dhe liqenet ndërkufitare, si dhe mbi ndikimin e shkarkimeve të turizmit në cilësinë e ujit. Metodat e avancuara për trajtimin e ujërave dhe teknologjitë e reja u paraqitën si zgjidhje të qëndrueshme për përmirësimin e cilësisë së ujit, përmes aplikimit të oksidimit të avancuar, biosorbentëve dhe biosensorëve. Këto qasje u vlerësuan për potencialin e tyre në mbështetje të zhvillimit të turizmit ekologjik dhe reduktimit të ndikimit të ndotësve në destinacionet turistike. Në sesione të tjera u analizua cilësia kimike dhe mikrobiologjike e ujit, si dhe ndikimi i saj në shëndetin publik dhe mirëqenien e komuniteteve lokale. Kjo përfshiu analizat e ujërave të pijshëm në zona turistike dhe praninë e përbërësve të rrezikshëm si metalet e rënda dhe antibiotikët. Po ashtu, u diskutuan qasjet për vlerësimin e bilancit të ujit dhe efektet e përmbytjeve, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë e infrastrukturës turistike dhe mjedisin përreth.




Temat e trajtuara ngjallën interes të veçantë në mesin e pjesëmarrësve, duke nxitur diskutime të hapura dhe interaktive. U theksua rëndësia e ndërthurjes së dijes shkencore me politikëbërjen dhe përfshirja aktive e institucioneve akademike në hartimin e strategjive për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore. Diskutimet dëshmuuan qartë se ruajtja e cilësisë së ujit është thelbësore për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm, si dhe për forcimin e qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale në nivel kombëtar dhe rajonal.



Në përmbyllje, akad. asoc. Besnik Baraj dhe akad. Fetah Podvorica nënvizuan se bashkëpunimi ndërmjet dy akademive ka krijuar një platformë të qëndrueshme për ndarjen e njohurive, nxitjen e projekteve të përbashkëta shkencore dhe ndërtimin e politikave të bazuara në evidenca shkencore. Ata njoftuan se konferenca e radhës do të mbahet në Prishtinë, në Maj të vitit 2026.

Ky aktivitet forcon rolin e shkencës si motor i zhvillimit të qëndrueshëm dhe konfirmon rëndësinë e menaxhimit të burimeve ujore si sfidë dhe mundësi për Shqipërinë, Kosovën dhe më gjerë.

“Albanoi” e Vasil S. Toles, magjia e një simfonie thellësisht shqiptare



Pas një përvoje të gjatë, kompozitori Vasil Sofokli Tole i ofroi publikut një simfoni me ashtë tërësisht shqiptar. Premiera botërore e “Albanoi” u luajt me datë 9 maj, 2025, në Ditën e Evropës, nga orkestra simfonike e Radio-Televizionit Shqiptar, nën drejtimin e Maestro Eno Koços. Kjo orkestër e themeluar më 16 maj të vitit 1962, rrënjët i ka, në fakt, në vitin 1938, kohë kur u krijua Radio Tirana dhe, pranë saj, u vendos një formacion orkestral që quhej Orkestra e Radio Tiranës, fillimisht nën dirigjimin e dirigjentit italian Umberto Rampi e pastaj, pas ’44-ës, nën dirigjimin e Mustafa Krantjës, Bojan Adamiçit etj. Krijues si Kristo Kono, Pjetër Dungu, Dhora Leka etj ishin ndër të parët që u interpretuan. Pas tyre orkestra simfonike e RTSH ka interpretuar krijimtarinë e pothuajse gjithë kompozitorëve shqiptarë prej At Martin Gjokës, At Fan S. Nolit, Murat Shehut, Çesk Zadejës, Tish Daisë, Tonin Harapit, Kozma Larës, Pjetër Gacit, Feim Ibrahimit, Limoz Dizdarit, Shpëtim Kushtës, Kujtim Laros, Thoma Gaqit, Hajg Zaharianit, Spartak Tilit, Gazmend Mullahit, Thomas Simakut, David Tukiqit, Josif Mingës, Zef Çobës, Aleksandër Peçit, Sokol Shupos, Ermir Dergjinit, Fatos Qerimit, Endri Sinës etj, e deri tek brezat më të rinj. Po ashtu krijimtarinë e krijuesve shqiptarë të Kosovës Rexho Mulliqi, Lorenc Antoni, Rauf Dhomi, Zeqirja Ballata, Fahri Beqiri etj. Ndërkohë, për t’u rikthyer te premiera e “Albanoi”. Të pranishmit, mes të cilëve kisha fatin të jem edhe unë, shprehën konsidereatën e tyre për këtë vepër të jashtëzakonshme, prandaj edhe vendosa që, nëpërmjet fjalëve të tyre, të tejçoja tek lexuesi i “ExLibris” një

shije, sado të zbehtë, të kësaj ngjarjeje madhore jo vetëm në jetën e kompozitorit, por në vetë jetën artistike të botës shqiptare, brenda e përtej vetë Shqipërisë. Një bisedë që pata fatin të zhvilloja me prof. Vason pak kohë më parë (ExLibris, nr. 304), e mbyllëm me fjalinë “Se si do të jetë kjo simfoni shqiptare e shek. XXI, besoj do të flasim përsëri, pas premierës së saj!” Dhe, meqë tani jemi përnjëmend pas premierës, po flasim për të, ama jo me kompozitorin, por me disa personalitete, të fushës ose jo, që e vlerësuan së tepërmi!



Prof. Dr. Fatmir Hysi, Muzikolog

Pas një periudhe të gjatë stagnimi dhe dominimi të muzikës komerciale, arti simfonik – dhe simfonia në veçanti – po rikthehet me një gjallëri të re. Vepra më e fundit e Vasil S. Toles, simfonia ALBANOI, është një shembull mbresëlënës i këtij rilindjeje, duke e vendosur zhanrin në një dritë të re dhe bashkëkohore. Simfonia të surprizon që në momentin e parë me tingujt e saj kompleksë dhe të papritur, si dhe me qartësinë e konceptit. Ajo digjet nga një zjarr i brendshëm, duke u frymëzuar nga dhe duke iu kushtuar kompozitorëve dhe figurave të rëndësishme kulturore. Megjithatë, ajo shkon përtej thjesht homazhit. Në vend që të ndjekë format tradicionale epike apo rrëfimore, ALBANOI sfidon audiencën të kalojë nga dëgjimi pasiv në përfshirje emocionale aktive – duke ftuar çdo dëgjues ta përjetojë muzikën si një udhëtim personal e bashkëkohor. Forma e disiplinuar e simfonisë, gjuha e freskët harmonike – e

ndërtuar në ndërthurjen midis teknikës profesionale të kompozimit dhe idiomave folklorike — dhe orkestracioni i kthjellët dhe kuptimplotë, i japin veprës një energji të gjallë dhe në zhvillim. Ngjyrat dhe teksturat e ndryshme timbrike shtojnë praninë dinamike dhe fuqinë shprehëse të saj. Me ALBANOI-n, Vasil S. Tole hap një rrugë të re për muzikën simfonike shqiptare — një rrugë që përqafon traditën dhe risinë, dhe riafirmon simfoninë si një medium të gjallë të shprehjes artistike bashkëkohore.

Helena Kadare, shkrimtare

Simfonia “Albanoi” e kompozitorit të shquar Vasil Tole ishte një surprizë tejet e bukur për gjithë artëdashësit e muzikës klasike. E ndërtuar në katër kohë, ajo shtjellonte një udhëtim të tipareve të shqiptarëve të të gjitha kohërave, nga ilirët deri në ditët tona. Salla e mrekullueshme e koncerteve në Katedralen Orthodhokse, ku u dha premiera, përcolli mrekullisht tek spektatorët fatlumë gamën e fuqishme të tingujve muzikorë të kësaj simfonie, të interpretuar mjeshtërisht nga orkestra simfonike e RTSH, nën drejtimin e mjeshtrit Eno Koço. Mbrëmje artistike të këtij niveli, i vijnë jo shpesh publikut artëdashës të Tiranës. Ata morën me vete emocione të jashtëzakonshme plot dritë, që nuk do t’i harrojnë për një kohë të gjatë.

Maestro Eno Koço, dirigjenti i simfonisë “Albanoi”

“Albanoi”, është një simfoni me përmasa të mëdha, shkon tek 45 minuta, me kohë të fuqishme. Një vepër, që është udhëtimi i Shqipërisë në këto 2 mijë vjetët e fundit. Vërtet, që nga koha e hershme, se kështu është, është me katër kohë, me katër etapa: I.EPOS, II. ISO, III.KTHESA, IV. Heng Dhe mbërrin në etapën e sotme. Ka gjendje të ndryshme emocionale; gjendja e kohës së I, shumëkush mund të thoshte ilirët, shqiptarët, arbërorët, pastaj dhe si transformohet dhe mbërrin tek koha e fundit që është shumë dinamike, e sotshme, që është një aheng, le të themi, është një gjendje shpirtërore e lartësuar. Interpretimi mua më hap shumë punë se kam shumë punë për të bërë me Orkestrën dhe në çdo moment e kam mendjen që si u zgjidh kjo e ajo, por kemi fatin që kemi Blertën e kemi Vason që na mbështesin në këtë punë dhe do të bëjmë më të mirën.

Prof. Robert Prendushi, muzikolog

Urime, urime. Tashma kemi dhe një sinfoni që flet me gjuhën e shekullit tonë. Konfrontimi, - venia ngjitur në një koncert me Shostakoviçin (kompozitor i madh i një vendi të madh) , me Komp. Tole, kompozitor gjithnji në rritje, ishte një guxim artistik që u përballue me sukses nga autori, dirigjenti dhe orkestra që e futi ndigjuesin shpejt në një botë të re. Arti ynë ka hy në Europë prej sa kohësh. Simfonia e V. S. Tole asht një tjetër dëshmi bindëse. Të përpiqemi që edhe publiku i gjanë të ndjekë gjithnji e ma

shumë. gjinitë e mëdha të muzikës. E kjo fillon nga shkolla.
Ju lumtë.

Akademik Gëzim Hoxha, Kryetar i Sesionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, Akademia e Shkencave


Vepra muzikore simfonike “Albanoi” ishte tërheqëse për mua që nga titulli simbolik i saj që të drejtonte menjëherë drejt rrënjëve historike. Nuk kisha gabuar. Tingujt e harmonizuar të pjesës Epos të fusnin në fantazinë e thellë të fillimeve historike. Pjesa “Iso” formëson me tinguj avancimin drejt formacioneve antike. Vazhdimi me “Kthesa-Valle” është një frymëzim që përputhet me “Rilindjen Ilire” dhe kristalizimin e një bashkësie etnike kompakte me gjuhë, territor, tradita, zakone, folklor dhe muzikë. Kurorëzimi i simfonisë me kohën e katërt “Heng-Finale” shënon kulmin e një veprë muzikore të mbështetur fort në histori. Ekzekutimi profesional i kësaj simfonie të V. Toles nga instrumentistët virtuozë të drejtuar nga dirigjenti ynë i dashur Eno Koço, më dha një kënaqësi të veçantë shpirtërore, një ndjenjë të veçantë estetike dhe një lesim ndryshe të historisë “Albanoi” nëpërmjet një veprë shumë të denjë muzikore.

Akademik Stefan Çapaliku, shkrimtar, dramaturg, Drejtor i Qendrës së Studimit të Arteve

Shkrimi një simfonie duhet konsideruar si një ngjarje e madhe kulturore dhe ekzekutimi i saj edhe më e madhe. Rasti i simfonisë së parë të kompozitorit të mirënjohur Vasil Tole është një shenjë e fortë se muzika serioze shqiptare nuk ka vdekë. Ajo është një yll shprese në qiellin e botës muzikore, që ecën denjësisht në gjurmët më të mira të profesorit të vet Çesk Zadeja. Ekzekutimi i saj prej filarmonisë së shtetit ndën drejtimin e maestro Eno Koços më nxori mallin e kohës kur muzika serioze shqiptare kishte stinët e veta të begata dhe më dha shpresë se një eksperiencë e tillë mund të rifillojë në dritën e estetikave të reja.

Botime të reja

Sapo ka dalë në dritën e botimit libri më i ri i akademik Rexhep Meidani me titullin “Mekanika kuantike - një paradigmë shekullore: shkencore, filozofike dhe teknologjike”.



Akad. Rexhep Mediani është anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe anëtar i Asamblesë së saj.

[#AShSh](#)

[#akademikRexhepMeidani](#)

[#Mekanikakuantikenjëparadigmëshekulloreshkencorefilozofikedheteknologjike](#)

<https://www.facebook.com/100006744721280/posts/4108298129404971/?mibextid=wwXIfr&rdid=2shhgaQaD1KKFSZE#>

U prezantua monografia "Kinemaja para gjyqit: nga kinokronikat e gjyqeve të popullit, te filmat e vigjilencës revolucionare të masave"



Veprimtaria u organizua sot, në datën 28 maj 2025, nga Qendra e Studimit të Arteve, pjesë e Akademisë së Shkencave.

Drejtori i QSA-së, akad. asoc. Stefan Çapaliku, përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi autoren për qasjen origjinale mbi kinokronikat e kinematografinë shqiptare.

Autorja dr. Jonida Gashi nëpërmjet një dialogu me moderatoren e kësaj veprimtarie, dr. Anxhela Çikopanon, rrëfeu për punën e saj kërkimore disavjeçare për marrëdhëniet mes kinemasë, drejtësisë dhe avangardës në Shqipërisë socialiste. Interesi rreth kësaj teme iu zgjua kur ndeshi pamjet filmike të proceseve gjyqësore kundër armiqve të popullit, të cilat ishin zhvilluar në sallat e kinemave shqiptare, nën regjimin komunist. Ajo tha se kinoditarët dhe dokumentarët e bazuar në punimet e gjyqeve të popullit ishin shumë të paktë në numër dhe shumë shpejt zbuloi se ndikimi i tyre në kinemanë e realizmit socialist shqiptar kishte qenë më i madh nga sa mund të merrej me mend. Më tej, dr. Gashi vuri në dukje se ky libër është rezultat i kërkimeve të një pune disavjeçare që u përfundua në Qendrën e Studimit të Arteve, pjesë e Akademisë së Shkencave, në vitin 2024, dhe shprehu

falënderimet e mirënjohjen për gjithë mbështetjen institucionale në krijimin e kësaj monografie.



Veprimtaria u mbyll me pyetje për autoren dhe diskutime për çështjet e trajtuara në monografinë "Kinemaja para gjyqit: nga kinokronikat e gjyqeve të popullit, te filmat e vigjencës revolucionare të masave".

www.akad.gov.al

U prezantua libri “Etnolettra shqipe” i autorit Vehbi Miftari



Në datën 13 maj 2025, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u prezantua libri i Vehbi Miftarit “Etnolettra shqipe” (Raporti i letërsisë me etnokulturën e kombformimin), ASHSH@Botimet Toena.

Kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike akad. asoc. Gëzim Hoxha bëri hapjen e promovimit.



Pas fjalës përshëndetëse, ai ia dha fjalën znj. Irena Toçi (Botimet “Toena”), e cila e vlerësoi autorin për kërkimet studimore në fushë të dijeve e të teorive mbi kombformimin, dijeve filozofike, sociologjike e kulturore, kulturën popullore e veprat e autorëve përfaqësues, nga humanistët e filobiblistët të romantikët e pasromantikët.

Prof. asoc. Evalda Paci, drejtuese e Departamentit të Letërsisë, ASHSH, dhe recesente shkencore e veprës bëri një vlerësim analitik të veprës, lidhur me studimet komplekse që ka bërë autori. Ajo e vlerësoi ndër të tjera veprën studimore si një shtysë evokimi dhe për të parë në dritë të njohjes nga vështrime të tjera vepra me të cilat hershmëria e dëshimit në shkrim e kulturë lidhet me emra të prelatëve të shekujve XVI e më tej. Më tej, prof. asoc. Paci theksoi se kultivimi i tematikave që kanë lidhje të natyrshme me kombëtarësinë ka krijuar një hapësirë që ndërmjetëson interpretime mbi lindjen dhe shfaqjen e romantizmit në letërsinë tonë, që nuk konceptohet e ndarë nga zhvillimet në arealet e vatrave kulturore që janë të lidhura me thelbin evropian të literaritetit dhe kulturës gjegjëse.



Në fund, ajo e përgëzoi autorin për shtrirjen e punës së tij studimore me autorë dhe vepra të humanizmit, letërsisë kishtare, letërsisë romantike dhe asaj pasuese në kohë e pikëpamje.

Akad Matteo Mandalà, Universiteti i Palermos, në pamundësi të pjesëmarrjes fizikisht, bëri një përshëndetje online për autorin dhe botuesit për botimin dhe prezantimin e librit. Ai u shpreh se “Etnolettra shqipe” është një libër që kish munguar në letrat shqipe. Përmbajtja e tij e mënyra e shtjellimit, ndërlidhja e letërsisë në fushat e

tjera, dhe horizontet e leximit që hap, janë të veçanta.



I pranishëm në këtë promovim ishte Ambasadori i Republikës së Kosovës në Tiranë, z. Skënder Durmishi. Ai mbajti një fjalë përshëndetëse, në të cilën e vlerësoi studimin për orientimin e vëmendjes ndaj autorëve që shënjuan historinë e shkrimit të letërsisë shqipe.

Redaktorja shkencore e librit znj. Majlinda Toçi foli për punën e përbashkët me autorin për të ruajtur parametrat e një vepre studimore dhe e vlerësoi librin si një udhëtim në kohë për të lexuar përmes thjerrëzave tona atë që kanë shkruar të moçmit tanë.

Në përfundim të veprimtarisë, autori i librit Vehbi Miftari falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, si dhe btuesit ASHSH@Botimet Toena. Ai u shpreh ndër të tjera se dijet mbi zhvillimin e kombeve s'kishin si të kuptoheshin e të shpjegoheshin mirëfilli pa i trajtuar ato të ndërlidhura me krijimtarinë letrare. Letërsia shqipe ishte zhvilluar e pashkëputur nga synimet e kombit shqiptar, ndërkohë që u kishte shërbyer qëllimeve kulturore lokale në bashkësitë kulturore të veriut, gjatë shekujve XVI-XVII, ose synimeve politike, në lëvizjen romantike, gjatë shekullit XIX, duke krijuar një lloj simbioze me këto pikëpamje. Ka qenë ky një lloj filli që e mbante atë të ndërlidhur me pikëpamje politike e kulturore dhe ka përcjellë vazhdimisht zhvillimin e saj.

www.akad.gov.al

Të reja nga bota akademike

Angjelin Preljocaj u pranua si anëtar i Akademisë së Arteve të Bukura të Francës



Angjelin Preljocaj, koreografi dhe artisti francez me origjinë shqiptare, një emër i madh në historinë botërore të baletit modern, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, u pranua zyrtarisht si anëtar i Akademisë së Arteve të Bukura të Francës.

Ky është gjithashtu një moment i madh krenarie edhe për Shqipërinë dhe për kulturën shqiptare.

Ndiqueni drejtpërdrejt në linkun e mëposhtëm ceremoninë speciale, që u zhvillua në Institutin e Francës (Institut de France).

<https://www.youtube.com/watch?app=desktop&v=b45LwyuBEnU>

Në përfundim të seancës, Angjelin Preljocajt iu dorëzua Shpata e Akademikut e krijuar posaçërisht për të nga Constance Guisset, artistja franceze e dizajnit me famë ndërkombëtare.

Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, i përcjell urime të përzemërta koreografit me famë botërore Angjelin Preljocaj.

<https://www.facebook.com/share/p/1BdWZ8HFWQ/?mibextid=wwXlfr>
www.akad.gov.al

In memoriam

**Akademik emeritus Bardhyl Golemi, (1932-2025) personalitet i shquar i shkencës,
anëtar i asamblesë së ASHSH u nda sot nga jeta**



Kryesia e ASHSH-së njofton me dhimbje në këtë orë të vonë ndarjen nga jeta të akademik emeritus Bardhyl Golemi.

Akad. emeritus Bardhyl Golemi është një personalitet me dije dhe kontribute të rralla në teoritë e elektroteknikës, me njohuri të thella në nënfushat të modernitetit postindustrial, si bioelektromagnetizmi dhe impaktet në shëndetin njerëzor dhe depistimi elektromagnetik në kushtet e popullatës së Shqipërisë.

E shtrirë në më shumë se shtatë dekada, veprimtaria e akademik emeritus Bardhyl Golemit ishte gjithnjë në kërkim të risive shkencore dhe në ndërthurje të dijeve tradicionale me disiplinat moderne.

Kreu gjimnazin në Vlorë. Ndoqi studimet dhe u diplomua në Institutin e Lartë Politeknik të Tiranës. Filloi punën po aty si pedagog i lëndës elektroteknika teorike, për të cilën hartoi dhe tekstin përkatës (1964-1966). Ndoqi një specializim në Shkollën e

Lartë të Elektricitetit në Paris (1972).

Bardhyl Golemi ka botuar veprën e plotë: “Bazat teorike të elektroteknikës” në tri pjesë, 1999–2002 (ripunim i zgjeruar teorik dhe metodik i tekstit të v. 1964–1966) dhe monografitë: “Lëkundjet në transformatorët e tensionit” (1984), “Zhvillimi i arsimit të lartë në Shqipëri” (1987, bashkautor), “LTL: Fusha elektromagnetike dhe shëndeti” (2004), “Shkolla shqiptare e elektroteknikës” (2005, bashkautor), tekstin “Sinteza e qarqeve elektrike” (1982), si dhe dhjetëra artikuj shkencorë e studimorë në fushën e elektro-teknikës dhe të problemeve të arsimit e të shkencës. Ka dhënë cikle të plota ligjëratah për 10 vjet në Universitetin e Prishtinës. Bardhyl Golemi ka qenë zv.ministër i Arsimit (1980–1991), kryetar i Këshillit Kombëtar të UNESCO-s (1982–1991), sekretar i Kolegjiut të Ministrisë së Arsimit (1983–1992), anëtar i Senatit të UT dhe UP; sekretar shkencor i Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike të ASHSH (1976–1980).

Është dekoruar me Urdhrin “Flamuri i Kuq i Punës” i kl. II; ka marrë Çmimin e Republikës të shkallës së parë.

Në vitin 2021, akad. Bardhyl Golemi u shpall fitues i “Çmimit të karrierës” nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë me me motivacionin: “Personalitet me veprimtari intelektuale universitare dhe akademike gjurmëlënëse brenda dhe jashtë vendit për mbi gjashtë dekada; anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nga viti 1999; i shquar për studimet e tij themeluese me rëndësi bazale në fushën e inxhinierisë elektrike dhe elektronike”.

I shprehim ngushëllimet më të thella familjes, miqve, kolegëve dhe bashkësisë akademike në vend, në hapësirën mbarëkombëtare e më gjerë.

I paharruar emri dhe vepra e Tij!

Tiranë më 19 maj 2025

* * *

Orari i veprimtarive në nderim të akademik Bardhyl Golemi

12.00- Akademi Përkujtimore në sallën ALEKS BUDA në ASHSH

13.00-15.00 Homazhe në sallën ALEKS BUDA

15.10- Fjala e përmortshme e nderimit në emër të ASHSH në oborrin e Akademisë

15.30- Përcjellja për në Varrezat e Sharrës

<https://akad.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/BGolemi.pdf>

www.akad.gov.al

U mbajt ceremonia solemne për t'i dhënë lamtumirën e fundit akademik emeritus Bardhyl Golemit

Akademik emeritus Bardhyl Golemi (1932-2025) u nda nga jeta më 19 maj 2025.

Në nderim të figurës së tij, Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë mbajti sot, më 20 maj 2025, një Akademi Solemne.

Ditën e homazheve e hapi akad. Neki Frashëri, Kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike. Ai e vlerësoi akad. emeritus Bardhyl Golemin si një nga figurat më të spikatura në botën akademike shqiptare, me një kontribut të jashtëzakonshëm si në shkencë dhe në edukim, që ka luajtur një rol të dukshëm edhe në funksionimin e Akademisë së Shkencave. Pasi u shprehu ngushëllimet në emër të kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë familjarëve, akademikëve, e gjithë atyre që ndajnë këtë humbje të madhe, akad. Frashëri i ftoi disa nga kolegët që të ndajnë fjalë mirënjohjeje dhe kujtime për akademik Bardhyl Golemin.



Akad. Dhimitër Haxhimihali e vlerësoi si një personalitet të njohur në fushën e arsimit të lartë dhe të shkencës në Shqipëri. Ai foli për karrierën e Bardhyl Golemit, që e nisi me medaljen e artë që mori pas diplomimit në gjimnazin “Ali Demi” dhe e vijoi me arritje të tjera, si përfundimi i shkollës së lartë në Universitetin Politeknik, ku u emërua pedagog menjëherë pas përfundimit të tij, si dhe për kontributin e akad. emeritus Golemit me hapjen e Universitetit të Tiranës, ku ai themeloi dhe drejtoi për 15 vjet

rresht katedrën e elektroteknikës. Më tej ai vlerësoi karrierën e zhvilluar prej afër 7 dekadash me veprimtari, botime shkencore e monografi të shumta dhe përmendi: veprën vëllimore “Bazat e elektroteknikës”, të cilën e ripunoi dhe e ngriti në nivelin e një traktati, si dhe botimin e ASHSH-së “Njeriu elektromagentik”, por edhe botimet e shumta me kontribut në arsimin e lartë.



Akad. Raimonda Bualjoti e vlerësoi si një ndër personalitet e arsimit dhe të shkencës tonë kombëtare akad. emeritus Golemin. Ajo tha se personaliteti i jashtëzakonshëm njerëzor dhe shkencor i profesorit vijnë në kujtesën dhe ndjesitë e të gjithë kolegëve dhe studentëve të tij me një mënyrë të thellë mirënjohjeje dhe nderimi për atë trashëgimi të çmuar shkencore që ai ka lënë. Ajo vlerësoi më tej si një shembull të shkëlqyer të një shkencëtari, kolegu dhe studiuesi të pasionuar të shkencave inxhinierike, që me horizontin e tij të gjerë, me njohuritë e tij të thella, me ndërgjegjen e tij të pastër, e me përkushtimin shembullor do të jetë edhe për të ardhmen modeli i shkencëtarit që ngriti lart shkollën e lartë shqiptare.

Akad. Vasil Tole, zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave, lexoi telegramin e ngushëllimit të dërguar nga Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Në këtë telegram, mes të tjerash, shkruhet se akad. Bardhyl Golemi ka dhënë kontribut të çmuar në punën kërkimore-shkencore në trajtimin të problemeve të bioelektromagnetizmit dhe të studimeve për korridoret elektromagnetike të linjave të telefonisë në Shqipëri. Përmes këtij telegrami, Kryesia e ASHAK-ut vlerëson faktin që akad. Bardhyl Golemi ka marrë pjesë në më se një dekadë në mbajtje të ligjëratave të studimeve themelore dhe pasuniversitare në Universitetin e Prishtinës gjatë viteve të

shtatëdhjeta të shekullit të kaluar. Kontributi i tij ka qenë domethënës në ngritjen e kuadrove të Fakultetit Teknik të Universitetit të Prishtinës, prej të cilit më vonë janë ndarë 4 fakultete. Ndarja nga jeta e akademik Bardhyl Golemit paraqet humbje të madhe për familjen, Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Universitetin Politeknik të Tiranës, si dhe për mbarë shkencën kombëtare.



Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike, prof. asoc. Astrit Bardhi foli për kontributet e çmuara të akad. emeritus Golemit në veprimtarinë e mësimdhënies, përfshirë dhe kontributin në trevat shqiptare. Ai e vlerësoi librin “Bazat teorike të elektroteknikës” si trashëgimi të çmuar në arsimin shqiptar.

Akad. Jorgaq Kaçani përmendi cilësitë e rralla të akademikut si njeri dhe shkencëtar. Ai theksoi faktin që Bardhyl Golemi hodhi bazat e inxhinierisë elektrike dhe elektronike dhe e cilësoi si Tesla-n shqiptar.

Akad. Neki Frashëri foli për figurën dhe personalitetin krijues të akad. emeritus Golemit. Ai tha se për të njohur personalitetin e tij, do të mjaftonte edhe një libër i vogël “Njeriu dhe elektronika”, si njëra nga shenjat që tregojnë për madhështinë e personalitetit të Bardhyl Golemit.

Fjalë mirënjohjeje ndau dhe prof. dr. Paskal Milo. Ai foli për miqësinë familjare që ka nisur mes prindërve që kanë punuar së bashku në arsim dhe e vlerësoi më tej personalitetin e akad. emeritus Bardhyl Golemit gjatë periudhës që ka drejtuar arsimin e lartë. Ai theksoi se në miqësinë me akad. emeritus Golemin vihej re komunikimi si

atdhetar, ku shpreheshin gjithmonë shqetësime profesionale. Prof.dr. Milo tha se me ndarjen e tij nga jeta ka humbur gjithashtu edhe shkenca shqiptare.

Në fund të Akademisë Solemne znj. Mirela Golemi, vajza e akad. emeritus Bardhyl Golemit, shprehu mirënjohjen e thellë për përkushtimin e Kryesisë së Akademisë së Shkencave në mbajtjen e ceremonisë dhe për vlerësimet e anëtarëve të ASHSH-së dhe kolegëve.

Më pas u mbajtën homazhet, ku anëtarë të Kryesisë dhe Asamblesë së ASHSH-së, familjarët, kolegët e miqtë nderuan akad. emeritus Golemin.

Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Gjinushi mbajti fjalën e përmotshme të përcjelljes nga Kryesia e ASHSH-së.

Në fjalën e tij ai e vlerësoi akad. emeritus Bardhyl Golemin si një mik të veçantë e shumë të shtrenjtë, koleg të vyer dhe një prej figurave emblematike të akademizmit shqiptar; si një përfaqësues të denjë të shkencave inxhinierike, si një personalitet të spikatur të kësaj fushe e si një pedagog e shkencëtar të devotshëm e erudit; për veprimtarinë e tij shkencore e botuese, si dhe për kontributin e veçantë të në zhvillimin e arsimit në Shqipëri.

Në fund, ai theksoi se figura e Bardhyl Golemit do të mbetet në historikun e Akademisë së Shkencave e të Universitetit të Tiranës, në kujtesën e tërë komunitetit arsimor e shkencor, të të gjithë miqve e dashamirësve të tij.

Në nderim e respekt të jetës së anëtarit të ASHSH-së akad. emeritus Bardhyl Golemit, si falënderim e mirënjohje për veprën e tij, Kryetari i Akademisë së Shkencave u shprehu familjarëve ngushëllime të përzemërta dhe i ftoi të pranishmit të mbanin një minutë heshtje.

www.akad.gov.al

Fjala e lamtumirës e Kryetarit të Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi për akademik emeritus Bardhyl Golemin



Të dashur familjarë të akademik Bardhyl Golemit,

Të nderuar akademikë!

Të nderur kolegë, miq e dashamirës të profesorit,

Jemi sot këtu për t'i dhënë lamtumirën e fundit një miku të veçantë e shumë të shtrenjtë, një prej figurave emblematike të akademizmit shqiptar inxhinierit të talentuar, profesorit të mirënjohur, anëtarit e kolegut tonë të vyer, akademik Bardhyl Golemi.

Bardhyli ka lindur në Dhrovjan të Sarandës më 11 maj të vitit 1932 e prej asaj dite ai u rrit, edukua e formua duke kaluar me sukses tërë hallkat e arsimimit që ndjek çdo i ri me ëndrra e ambicie të mbështetura vetëm tek aftësitë e veta. Në të gjitha nivelet e shkollimit, nga shkollimi i mesëm në Vlorë, tek ai i lartë në Institutin Politeknik në Tiranë e deri te specializimi pasuniversitar në Grand Ecole D'electricite, në Paris, për Bardhylin pati vetëm një vlerësim: nxënës e student i shkëlqyer. I tillë do të ishte

vlerësimi për të në tërë rrugëtimin e tij që ndali sot, në çdo hap e fazë të jetës si njeri, profesor e shkencëtar, që përcillte në çdo moment urtësi, dashamirësi e dituri.

Me të njëjtin përkushtim e meritë, me të njëjtat cilësime nga kolegët e tërë komuniteti akademik, arsimor e shkencor, ai mbrojti e fitoi gradat e titujt docent, doktor i shkencave e profesor në fushat e tij të jetës, ato të elektricitetit e elektroteknikës, për t'u zgjedhur më 1999 anëtar i Akademisë sonë, si një përfaqësues i denjë i shkencave inxhinierike, si një personalitet i spikatur i kësaj fushe, si një pedagog e shkencëtar i devotshëm e erudit.



Profesor Bardhyli ka një kontribut të veçantë në zhvillimin e arsimit në Shqipëri, të të gjitha niveleve, e veçanërisht të arsimit të lartë, si drejtues e pedagog; si një prej themeluesve të Universitetit të Tiranës ku punoi si mësimdhënës që prej vitit 1958; si themelues e drejtues i katedrës së parë të elektroteknikës; si kontribuues i shkollës doktrale të inxhinierisë elektrike; udhëheqës i dhjetëra diplomave universitare e pasuniversitare; hartues i disa kurrikulave universitare; anëtar senati e këshillash shkencor të universitetit; anëtar redaksie i revistave shkencore. Me veprimtarinë e tij profesori kontribuoi në formimin e dhjetëra gjeneratave të inxhinierëve elektrikë në Shqipëri e Kosovë, mbi 5000 studentë kanë pasur fatin të dëgjojnë ligjëratat e tij në aulat universitare në Tiranë e mbi 500 në Prishtinë; ata patën fatin të mësojnë bazat teorike të elektroteknikës prej babait themeltar të kësaj lënde në shkollën tonë të lartë, për të cilën ruajnë edhe sot mbresat më të mira.

Pasioni i tij për arsimin, të cilit i kushtoi tërë jetën, interesi i tij i vazhdueshëm për formimin e brezave të rinj, kërshëria e vizioni i tij për nevojën që ka arsimi, për reforma reale e të guximshme u shfaqën me profesionalizëm e kompetencë sa herë që iu ngarkua përgjegjësia të jetë një nga drejtuesit e këtij sektori delikat e veçanërisht gjatë ushtrimit të funksionit të zëvendësministrit të arsimit; pa asnjë mëdyshje arsimi shqiptar ka vulën e kontributit të akademik Golemit në kapërcimin e mjaft momenteve delikate.

Të njëjtin pasion e vizion tregoi deri në fund miku ynë për reformimin e rrugën që duhet të ndjekë Akademia e Shkencave dhe shkenca shqiptare, në kohën e sotme, çdo bisedë me profesorin në çdo moment, edhe kur kishte probleme të veta të shëndetit, drejtohej menjëherë tek problemet e arsimit e të shkencës e këtu nuk fliste vetëm bazuar mbi përvojën e tij shumëvjeçare e si ish sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave, por dhe mbi tërë informacionet e prirjet e reja me të cilat ai njihej përditë, sikur të ishte në jetën aktive.



Profesori i shihte të pandara arsimin nga shkenca, punën e pedagogut si mësimdhënës nga ai i kërkuesit shkencor që kur shkenca shqiptare hidhte hapat e parë. Në veprimtarinë e tij mbi 60-vjeçare zë një vend të veçantë veprimtaria e tij shkencore e botuese, ku përfshihen botime bazike si “Praktikumi i bazave teorike të elektroteknikës”, “Lëkundjet në transformatorët e tensionit”, “Sinteza e qarqeve elektrike”, “Probleme të veçanta të bioelktromagnetizmit”, “Zhvillimi i arsimit të lartë në Shqipëri”, “Shkolla shqiptare e elektroteknikës”, hartimin e “Fjalorit Enciklopedik

shqiptar”, si dhe një sërë artikujsh shkencorë e pedagogjikë e referimesh në konferenca ndërkombëtare. Profesori është hartues i veprës me tri vëllime “Bazat teorike të elektroteknikës”, vepër që do t’i bënte nder çdo profesori e shkolle të lartë të nivelit europian.

Për veprimtarinë e tij të gjithanshme e të shkëlqyer, si inxhinier, pedagog, profesor e akademik ai është vlerësuar me një sërë çmimesh si “Çmimi i Republikës”, Urdhri “Naim Frashëri”, Urdhri “Flamur i Kuq i Punës” e si një qytetar i devotshëm, si një njeri me zemër të madhe gjithnjë dashamirës e i lidhur me vendin e tij, është zgjedhur dhe “Qytetar Nderi” i qytetit të Vlorës.



Mbi të gjitha, profesor Golemi, kolegu e miku ynë, ka vlerësimin e mirënjohjen e tërë Asamblesë së Akademisë së Shkencave, si shkencëtar e njeri, si koleg e bashkëpunëtor, si përfaqësues i denjë i gjeneratave të para e të ndritura të akademikëve shqiptarë. Për akademinë e anëtarët e saj, të vjetër e të rinj, do të jetë gjithnjë një nder e krenari që në radhët e saj ushtroi veprimtarinë e tij për 26 vjet me radhë profesor Bardhyli. Këtë vlerësim e mirënjohje ne u përpoqëm t’ia shprehnim mikut tonë duke i akorduar me meritë e përulje në vitin 2021 çmimin e karrierës me motivacionin: “Personalitet me veprimtari intelektuale universitare dhe akademike gjurmëlënëse brenda dhe jashtë vendit për mbi gjashtë dekada; anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nga viti 1999; i shquar për studimet e tij themeluese me rëndësi bazale në fushën e inxhinierisë elektrike dhe elektroteknike; autor i katër monografive dhe gjashtë

teksteve universitare që u kanë shërbyer e u shërbejnë për më shumë se një gjysmë shekulli dhjetëra brezave studentësh e studiuesish; me një rol të dukshëm cilësor në drejtimin e qendrave dhe organizatave shkencore prej njësive bazë deri te Komisioni Kombëtar i UNESCO-s; duke ushtruar me sukses funksione të larta në administratën shtetërore dhe institucionet shkencore; i vlerësuar në botën shkencore jashtë vendit dhe i përfshirë në borde të tribunave shkencore të njohura; fitues i mirënjohjeve të larta qytetare në nivel kombëtar”.



E tillë do të mbetet figura e Bardhyl Golemit në historikun e Akademisë së Shkencave e të Universitetit të Tiranës, në kujtesën e tërë komunitetit arsimor e shkencor, të të gjithë miqve e dashamirësve të tij. Po aq krenarë janë e do të jenë për profesorin si njeri e shkencëtar, si bashkëshort e prind shembullor, familjarët e tij, të cilëve më lejoni t’iu shpreh në emër tuaj, të Asamblesë së Akademisë së Shkencave, ngushëllimet më të përzemërta.

Të nderuar miq e kolegë!

Sot, në këtë ditë e moment trishtimi, ikën fizikisht prej nesh një shkollë e madhe e dijes kombëtare, ju ftoj të mbajmë një minutë heshtje në nderim të jetës e veprës së akademik Bardhyl Golemit.

Lamtumirë, mik i shtrenjtë!

www.akad.gov.al